




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCËS  
07/Nr. 104/02-31411/24  
Kaçanik, 16. 12. 2024



Bazuar në nenin 62.3 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008 e datës 04 Qershor 2008), nenin 78.6 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01 Nr. 60/01-12895/20, neni 31 i Rregullores 01Nr.104/01-1991/21 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale, Rregullores për Transport Rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut 01 Nr. 07 - 344 - 32032 / 14, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, bën këtë:

## **SHPLLJE PUBLIKE**

**PËR VAZHDIMIN DHE NDARJEN E VIJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK TË UDHËTARËVE NË KOMUNIKACIONIN LINJOR DHE LËSHUARJEN E LEJEVE TË PUNËS PËR VITIN**

**2025**

Me këtë shpallje publike, njoftohen të gjithë operatorët e interesuar që merren me transportin publik të udhëtarëve me autobus, kombi-bus dhe automjete me 4+1 ulëse, se mund të aplikojnë për marrjen e lejes së punës për vitin 2025 dhe ate:

1. Për linja me autobus, (kombi-bus në ato vija ku nuk mund të operoj autobusi), mund të aplikojnë në:

Linjat:

1. Kaçanik - Kovaçec
2. Kaçanik - Biçec
3. Kaçanik - Nikaj
4. Kaçanik - Rekë
5. Kaçanik - Imisht (Dubravë)
6. Kaçanik - Soponicë
7. Kaçanik - Sepetin (Dubravë)
8. Kaçanik - Strazhë
9. Kaçanik - Glloboçicë
10. Kaçanik - Doganaj
11. Kaçanik - Elezaj
12. Kaçanik - Kaçanik i Vjetër
13. Kaçanik - Begracë
14. Kaçanik - Stagovë
15. Kaçanik - Duraj - Gabrricë
16. Kaçanik - Semajë
17. Kaçanik - Kotlinë
18. Kaçanik - Ivajë
19. Kaçanik - Gajre
20. Kaçanik - Bajnicë
21. Kaçanik - Runjevë
22. Kaçanik - Gërlicë e Epërme

## **2. Kushtet për pajisje me Licencë (Leje Pune) për transport publik të udhëtarëve:**

**Leja e punës për autobus mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:**

- a) Aplikacioni,
- b) Të ketë në pronësi së paku dy (2) autobusë,
- c) Të ketë të punësuar së paku një shofer profesionist të kategorisë "D",
- d) Një mekanik për mirëmbajtje, respektivisht kontratën me servisën për mirëmbajtje të autobusëve,
- e) Biznesin e regjistruar në MTI,
- f) Selinë e kompanisë në territorin e komunës sonë,
- g) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.
- h) Certifikata e mjekut, për shoferë të autobusëve,
- i) Patentë shoferi për kategori "D" (kopje) e vërtetuar nga organi komunal (të ketë më tepër se dy vite përvojë),
- j) Librezat e qarkullimit për autobusët (kopje) të vërtetuara nga organi komunal,
- k) Rendi i Udhëtimit (orari i nisjes - kthimit), të vërtetuara nga drejtoria,
- l) Kontratën për peronimin e autobusëve për nisje dhe kthim,
  - a) PAGESA PËR VËRTETIM E RENDIT TË UDHËTIMIT PËR AUTOBUSË 25 €.
  - b) PAGESA PËR VËRTETIMIN E RENDIT TË UDHËTIMIT PËR MINIBUS 20€

2.1 Dy minibusë - në terrenet ku nuk mund të operojnë autobusët, për shkak të konfiguracionit të terrenit.

## **3. Leja e punës për operator me kombi bus me 8+1 ulëse do të jepet në linjën në të cilën nuk mund të operoj autobusi dhe minibusi dhe aplikuesi duhet të plotëson këto kritere:**

- c) Aplikacioni,
- d) Patentë shoferi (kopje)
- e) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se 5 vite,
- f) Të ketë në pronësi së paku dy kombi bus me 8+1 ulëse,
- g) Të jetë banor i komunës së Kaçanikut,
- h) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
- i) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- j) Kontratën për peronim për nisje dhe kthim,
- k) Certifikata e mjekut,
- l) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- m) PAGESA PËR VËRTETIMIN E RENDIT TË UDHËTIMIT KOMBI - BUS 15 €.
- n) PAGESA PËR VËRTETIMIN E RENDIT TË UDHËTIMIT PËR MINIBUS 20€
- o) Dy fotografi.

**4. Leja e punës për taksì veturë (4+1) mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:**

- a) Aplikacioni,
- b) Letërnjoftimi (kopje),
- c) Libreza e qarkullimit (kopje),
- d) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite të kategorisë "B",
- e) Automjeti të ketë pesë (05) dyer,
- f) Automjeti të ketë 4+1 ulëse,
- g) Automjeti të ketë taksimetër,
- h) Të posedoj çertifikatën e regjistrimit të biznesit,
- i) Të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari,
- j) Automjeti të ketë të vendosur firmën "TAXI" në pjesën e përparme të kulmit të automjetit, e cila duhet të ndriçoj natën,
- k) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- l) Çertifikata e mjekut,
- m) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- n) Pagesa për vazhdimin dhe ndërrimin e lejes për autotaksi 5€
- o) Dy fotografi.

**5. Leja e punës për Kompani Taksi - Operator Taksi, mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:**

- a) Aplikacioni,
- b) Të ketë selinë në teritorin e komunës së Kaçanikut,
- c) Të ketë çertifikatën e regjistrimit të biznesit,
- d) Të ketë së paku tri (03) automjete në pronësi, me ngjyrë të njejtë (librezat e qarkullimit - kopje),
- e) Të gjithë shoferët e punësuar, të posedojnë patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite,
- f) Të ketë vendparkim, frekuenca, zyrë, lidhje telefonike dhe kontratën apo servisin për mirëmbajtje të automjeteve,
- g) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
- h) Çertifikata e mjekut,
- i) Dëshmi për sigurimin e pasagjerëve,
- j) Pagesa për vazhdimin dhe ndërrimin e lejes për autotaksi 5€
- k) Dy fotografi.

**Afati për paraqitjen e aplikacioneve do të jetë 15 ditë, nga dita e publikimit.**

Në mungesë të dokumenteve të kërkuara, kërkesa do të refuzohet.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në Zyrën e Pranimet, nr. 8/ kati i I-rë.

Për më shumë informacione dhe për marrjen e aplikacionit, mund t'i drejtoheni Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencës.

**Vërejtje:** Të gjithë operatorët në vija të rregullta të Transportit Publik të Udhëtarëve, me: Autobus dhe Kombi - Bus, krahas dokumentacionit të lartshënuar, duhet të paraqesin edhe çmimet e mujoreve dhe biletave, sipas Rendit të Udhëtimit, pasi që çmimorja e paraqitur do të vërtetohet edhe nga drejtoria përkatëse.

